

U D H Ë Z I M
Nr. 1/1, datë 17.12.2002

**PËR KRITERET E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 666,
DATË 26.10.1998 "PËR DISA MASA LIDHUR ME PROCESIN E LIKUJDMIT TË
NDËRMARRJEVE TË VARTËSISË SË ISH AGJENCISË QENDRORE TË
RISTRUKTURIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE"**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 26.10.1998, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit,

U D H Ë Z O J N Ë:

1. Debitorët e krijuar në ndërmarrjet e vartësisë së ish AQRP-së, NB-ve, nga shitja e pasurisë shtetërore me këste sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 26.10.1993, detyrimet financiare të pashlyera do t'i paguajnë 100 për qind me lekë, të pa indeksuara me indeksin e çmimeve.

Për objektet, privatizimi i të cilëve është ndërprerë nga shkrirja e ish AQRP-së, NB-ve, dokumentacioni i privatizimit do të plotësohet ose përgatitet nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit e rrethit përkatës e cila e dërgon atë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, që këtëj në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit dhe kjo e fundit në Degën e AKP-së për lidhjen e kontratës së shitblerjes.

2. Debitorët privatë, të krijuar nga vlera e paradhënieve kulturele në bujqësi, për vlerën e vreshtave, agrumeve, ullinjve dhe drufrutorëve të tjerë, si efekt i shpërndarjes së tokave nga ish ndërmarrjet bujqësore, t'i paguajnë detyrimet financiare me bono privatizimi, letra me vlerë, ose me lekë pa u indeksuar këto detyrime financiare me indeksin e çmimeve.

3. Debitorët privatë, të krijuar nga shpërndarja e kafshëve, automjeteve, traktorëve, makinerive dhe pajisjeve të ndryshme bujqësore të ish NB-ve, shumat e papaguara t'i shlyejnë me letra me vlerë, ose bono privatizimi pas indeksimit me indeksin e çmimeve të mallrave të konsumit.

4. Të gjithë debitorët privatë, krijuar nga vlera e objekteve ndërtimore të kontabilizuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 15.8.1994 ose në rastet e tjera të konstatuara për periudhën e mëvonshme, detyrimet financiare t'i paguajnë 100 për qind në lekë. Vlera e çdo objekti ose pjesë e tij do të llogaritet sipas kreut I, paragrafi i parë dhe pikës 1 paragrafi i parë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, (vlera kontabël e mbetur korrigjohet si me koeficientin e indeksit mujor ashtu edhe me atë të vendndodhjes).

5. Kontratat e shitjes së objekteve, të lidhen nga degët e AKP-së në rrethet përkatëse, sipas dokumentacionit të përgatitur nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit i cili kalon në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencinë Kombëtare e Privatizimit. Kjo e fundit e dërgon atë, në Degët e AKP-së së rrethit përkatës.

6. Arkëtimi i detyrimeve financiare nga shitja e pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve bujqësore që bëhet në lekë, 5 për qind të vlerës të arkëtuar të derdhet në favor të AKP-së.

7. Debitorët privatë, të krijuar nga marrja e paradhënieve për shërbime dhe të pakthyer nga paga e dieta të marra padrejtësisht, për vjedhje, shpërdorime e përvetësime, etj., të kësaj natyre, për të cilat ekziston dokumentacion i plotë ligjor, detyrimet financiare t'i shlyejnë 100 për qind me lekë dhe të indeksuara me indeksin e çmimeve të muajit paraardhës në të cilin bëhet pagesa.

8. Debitorët dhe kreditorët shtetërore ose në persona, që aktualisht ndodhen të regjistruar në kontabilitetin e ndërmarrjeve të vartësisë së ish AQRP-së të NB-ve dhe janë pa shpresë arkëtim/pagese, (pika 2,3,7 e këtij udhëzimi) të mbyllen.

9. Privatizimi i pasurisë shtetërore, i ndërmarrjeve të varësisë së ish AQRP-së të NB-ve, e cila aktualisht është e pa privatizuar dhe e pazaptuar, të bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.197, datë 20.3.1998 dhe ndryshimeve të mëvonëshme të tyre.

10. Për probleme të veçanta që mund të dalin nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 26.10.1998 të cilat nuk janë trajtuar në këtë udhëzim, për çdo rast do të vepohet me

urdhër të veçantë të lëshuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

11. Udhëzimi nr.1, datë 23.2.1999 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi të jetë botuar në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit
Arben Duka

Ministri i Ekonomisë
Arben Malaj